2. Autoriteti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:
 - a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë e përshtatshme në procedurat me faza;
 - b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;
 - c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
 - d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit kontraktor ka ndryshuar;
 - e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021, të ndryshuar.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.
4. Nëse, Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të rishpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna, nuk duhet të vijojë me rishpalljen e saj në Sistemin e Prokurimit Elektronik përpara përfundimit të afateve të ankimimit/shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të marrë lidhur me to.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1: Formulari i Ofertës Ekonomike

Shtojca 2: Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.

Shtojca 3: Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4: Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 5: Deklaratë mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Shtojca 6: Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 7: Formulari i shërbimeve dhe Grafikut të ekzekutimit

Shtojca 8: Termat e Referencës

Shtojca 9: Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 10: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit.....

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të Skualifikimit.....

Shtojca 12: Formulari i Njoftimit të Fituesit pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Formulari 13: Formulari i Njoftimit të Fituesit në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit

Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 16: Formulari i Njoftimit të Anulimit të Procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁵

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt: **[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme::
 - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 - 2. Njoftimin e Kontrates;
 - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 - 4. Specifikimet teknike, grafikun e realizimit, termat e referencës;
 - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 - 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
 - 7. Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.
- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

⁵ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

(f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)***LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ELEMENTËVE PËRBËRËS TË SHËRBIMIT****Data:** _____**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:**
_____**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë**
(në rast BOE): _____**Monedha:** _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë elementëve përbërës të ofertës ekonomike duhet t'u vendoset çmimi i ofruar në këtë Listë, pasi elementët e Ofertës ekonomike pa vlerë do të konsiderohen si shërbime të paofruara dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>5</i>	
Nr.	Përshkrimi i elementëve të përbërës të Ofertës Ekonomike	Sasia	çmimi për njësi	Çmimi total (3 x 4X)	
1.	Shërbim i zhvillimit të mirëmbajtjes së Programit të Taksave dhe Tarifave Vendore	1			
2.					
3.					
4					
	Çmimi total				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 3.

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

(⁶Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik)

DEKLARATË

Mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Deklaratë për procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga
Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____, në cilësinë e anëtarit të stafit të operatorit ekonomik
“.....” për procedurën e prokurimit me objekt _____ nën
përgjegjësinë time personale, **Deklaroj** se:

1. Autorizoj VETËM operatorin ekonomik “.....” të paraqesë
personin tim dhe të gjithë dokumentacion e nevojshëm, si anëtar i stafit të tij në procedurën e
prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti
Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Deklarimi i personit tim, si anëtar i stafit nga ana e çdo operatori ekonomik tjetër, për procedurën e
prokurimit me objekt _____, është i pamiratur dhe
pa pëlqimin e personit tim.

2. Jam i disponueshëm në realizimin e objektit të prokurimit, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara
nga autoriteti kontraktor.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula

⁶ Kjo Shtojcë do të paraqitet në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme.

Shtojca 6 .

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor*]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

- a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;
- b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit;
- c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

1. Qëllimi i shërbimit

Qëllimi i këtij shërbimi është sigurimi i mirëmbajtjes funksionale dhe teknike të Sistemit Informatik të Taksave të Bashkisë së Tiranës, i cili përdoret për menaxhimin, gjenerimin dhe arkëtimin e detyrimeve tatimore vendore të subjekteve dhe pronarëve të pasurive.

Ky shërbim synon garantimin e vazhdimësisë së punës së sistemit, integritetin e të dhënave, sigurinë, si dhe zbatimin e azhurnimeve dhe përmirësimeve të nevojshme sipas ndryshimeve ligjore dhe fiskale.

2. Objekti i shërbimit

Objekti kryesor i këtij shërbimi është Mirëmbajtja e Sistemit Informatik të Taksave të Bashkisë Tiranë, në çdo komponent të tij, me qëllim sigurimin e vazhdimësisë së punës dhe disponueshmërisë së plotë të shërbimeve që ofrohen për administrimin e taksave dhe tarifave vendore.

Ky sistem mbështet proceset kryesore të regjistrimit të subjekteve, përlllogaritjes së detyrimeve, gjenerimit të njoftimeve, raportimit dhe arkëtimit të të ardhurave vendore. Mirëmbajtja e tij përfshin monitorimin, përditësimin dhe sigurimin e funksionalitetit të pandërprerë të të gjithë moduleve funksionale dhe infrastrukturës teknike.

Komponentët kryesorë të sistemit, që janë edhe objekt direkt i këtij shërbimi, përfshijnë:

i. Moduli 1 – Aplikacioni Klient-Server

Ky modul është përgjegjës për ruajtjen, administrimin dhe gjenerimin e detyrimeve të subjekteve dhe pronarëve të pasurive sipas VKB-ve përkatëse.

Aplikacioni është zhvilluar në ambientin Unify SQL Windows 5.1 dhe përdor RDBMS Oracle 11g R2 për menaxhimin e bazës së të dhënave.

Përmes këtij moduli realizohet:

Regjistrimi, azhurnimi dhe menaxhimi i subjekteve tatimpaguese dhe njësive të tyre;

Përlllogaritja automatike e taksave dhe tarifave sipas VKB-ve në fuqi;

Llogaritje automatike të penaliteteve (gjobave dhe kamatëvonesave);

Gjenerimi i njoftimeve tatimore dhe dokumenteve të detyrimit;

Administrimi i historikut të pagesave dhe kamatëvonesave;

Raportim i avancuar financiar dhe statistikë operative për drejtori të ndryshme të DPTTV.

Ky modul është thelbësor për funksionimin e përditshëm të sistemit dhe kërkon mirëmbajtje të vazhdueshme funksionale, testim periodik dhe përditësim sipas ndryshimeve ligjore dhe fiskale.

ii. Moduli 2 – Webservice-t për Komunikimin me AKSHI (shërbimet për biznesin ,qytetaret taksapagues dhe pagesat).

Ky modul siguron shkëmbimin e të dhënave ndërmjet sistemit të DPTTV-së, platformave të AKSHI-t (shërbimet për biznesin ,qytetaret taksapagues dhe pagesat), duke garantuar integritetin, sigurinë dhe gjurmueshmërinë e transaksioneve.

Ai funksionon përmes webservice-ve të bazuara në SOAP dhe REST, duke përdorur protokollet HTTPS dhe certifikatat dixhitale të lëshuara nga AKSHI për autentifikim dhe enkriptim.

Struktura teknike e modulit përfshin:

- Endpoint-e REST/SOAP për kërkesat hyrëse dhe dalëse;
- Enkriptim të komunikimit sipas standardit TLS 1.3;
- Logim të detajuar për auditim dhe kontroll;
- Validim automatik të të dhënave dhe trajtim të gabimeve në kohë reale.

Funksionalitetet kryesore përfshijnë:

- Shkëmbimin e të dhënave të pagesave ndërmjet DPTTV dhe AKSH-it (e-albania);
- Sinkronizimin e të dhënave me sistemet e AKSHI-t për raportim dhe verifikim;
- Ruajtjen e historikut të komunikimeve dhe auditimin e çdo operacioni;
- Mekanizma për rikuperim automatik në rast dështimi (retry logic) dhe sistem alarmimi në kohë reale.

Ky modul është projektuar për komunikim online me AKSHI-n (shërbimet për biznesin ,qytetaret taksapagues dhe pagesat).

iii. Moduli 3 – Webservice për Dërgimin e Njoftimeve në e-Albania

Ky modul mundëson dërgimin e njoftimeve zyrtare PDF dhe mesazh nga sistemi i DPTTV në platformën e e-Albania, në mënyrë të sigurt, të automatizuar dhe të gjurmueshme.

Ai realizon integrimin përmes API-ve RESTful të e-Albania, në përputhje me kërkesat e AKSHI-t për komunikim institucional elektronik.

Elementët kryesorë përfshijnë:

- Gjenerimin dinamik të njoftimeve sipas 4 tipologjive (Njoftim detyrimi, Njoftim për Pagesë nga DPTTV, Dërgim Informacioni për Detyrimet e Mbartura të Pronës DPTTV, Njoftim i Masave Shtrënguese nga DPTTV).
- Verifikimin e identitetit të përdoruesve përmes NID-it dhe sistemit të autentifikimit të e-Albania;
- Dërgimin e njoftimeve në formate JSON/XML përmes API-ve të certifikuara;

- Konfirmimin automatik të pranimit dhe regjistrimin e statusit në databazë;
- Auditimin dhe gjurmimin e çdo njoftimi për transparencë dhe kontroll institucional.

Sistemi mbështet mekanizma rikthimi (callback) dhe njoftime automatike në rast dështimesh, me ruajtje të plotë të logeve për analiza, statistika dhe raportim periodik.

Ky modul është i ndërtuar në mënyrë të zgjerueshme për integrim të ardhshëm me platforma të tjera njoftimi qeveritare.

Pavarësisht se kjo kontratë në thelb synon procesin e mirëmbajtjes së sistemeve të sipërpërmenduar, DPTTV-ja kërkon herë pas here të kryhet azhurnim, përmirësim apo modifikimin i Aplikimit apo Infrastrukturës mbi të cilën ekzekutohet ky aplikim.

3. NDËRFAQJA DHE FUNKSIONALITETET E SISTEMIT

Sistemi Informatik i Taksave Vendore i Bashkisë Tiranë ofron një **ndërfaqe grafike shumëpërdorimshe**, e ndërtuar në ambientin **Unify SQLWindows** me bazë të dhënash **Oracle 11g R2**.

Aplikacioni është dizajnuar për të lehtësuar punën e administratës tatimore vendore në proceset e regjistrimit, përlllogaritjes, arkëtimit dhe raportimit të detyrimeve tatimore.

Në pjesën e sipërme të ekranit shfaqet menuja kryesore, e ndarë sipas moduleve funksionale të sistemit. Më poshtë paraqiten përshkrimet e detajuara për çdo seksion:

Menu “Referencat”

Ky modul përmban strukturën bazë të të dhënave referuese të sistemit:

- **Struktura Administrative** – regjistrimi i njësive administrative, rrugëve dhe zonave;
- **Regjistrimi i Bankave** – për konfigurimin e kanaleve të arkëtimit;
- **Formave Juridike dhe Parametrave** – përcaktimi i formave të subjekteve, kodeve tatimore dhe parametrave fiskalë;
- **Tipet e Dokumentave dhe Raportet e Programit** – menaxhim i formateve të dokumenteve fiskale dhe raporteve standarde.

Ky seksion garanton konsistencën e të dhënave dhe unifikimin e strukturës organizative të Bashkisë Tiranë.

Menu “Subjektet”

Ky modul përfshin funksionalitetet për **regjistrimin, menaxhimin dhe përditësimin e subjekteve tatimpaguese**:

- **Regjistrimi i Subjekteve dhe Pronave** – hapja e kartelës tatimore për çdo subjekt juridik ose fizik;
- **Regjistrimi i Njësive dhe Komponentëve të Aktivitetit** – lidhja e pronave me aktivitetet ekonomike;
- **Ndryshimi i të Dhënave dhe Gjendjes së Subjektit** – përditësimi i pronësisë, statusit aktiv ose pezullimit të aktivitetit;

-
- **Të Dhënat nga Sistemi i Tatimeve** – shkëmbim automatik i të dhënave me sistemin qendror fiskal, me kerkim tek e tek per cdo nipt.
 - **Dërgimi i Mesazheve dhe Dokumenteve [e-Albania]** – komunikim elektronik me subjektet përmes platformës qeveritare.

Ky modul është thelbësor për integrimin institucional dhe garanton gjurmueshmëri të plotë të çdo ndryshimi në të dhënat tatimore.

Menu “Detyrimet”

Moduli më kritik i sistemit, që mundëson:

- **Gjenerimin Fillestar të Detyrimeve** (automatik ose manual për çdo subjekt);
- **Lidhjen e Llojeve të Aktiviteteve me Detyrimet përkatëse;**
- **Përcaktimin e Detyrimeve sipas VKB-ve** për taksa të pronës, pastrimit, tabelave, etj;
- **Regjistrimin e normës së Kamatvonesave.**

Ky modul përfshin logjikë automatike fiskale që siguron korrektësinë e përlogaritjeve sipas ligjit në fuqi.

Menu “Likujdimet”

Moduli i arkëtimeve, që administron të gjitha proceset e pagesës:

- **Veprime me Bankën** – regjistrimi i urdhërpagesave, anulimet dhe kalimi automatik i arkëtimeve;
- **Trajtimi i Tepricave dhe Rimbursimet** – menaxhimi i diferencave të pagesave, kompensimeve dhe kthimeve të shumave.

Këto funksione garantojnë integritetin e të dhënave të arkëtimeve dhe sinkronizim të saktë të pagesave në kanalin online.

Menu “Raportet”

Ky modul ofron **raportim analitik dhe statistikë fiskale** për çdo aspekt të sistemit:

- **Raporte për Subjektet** – të dhëna të përgjithshme, ndryshime të bizneseve, regjistra debitorë/kreditorë;
- **Raporte për Personat, Pronat dhe Detyrimet** – struktura analitike sipas kategorive të taksave;
- **Raporte për Arkëtimet dhe Përdoruesit**
- Raportet mund të eksportohen në **Excel** dhe **PDF** dhe janë të personalizueshme sipas kërkesave të DPTTV-së.

Menu “Dokumentat”

Mundëson **menaxhimin elektronik të dokumentacionit fiskal:**

- Regjistrim, ndryshim dhe listim të dokumenteve zyrtare;
- Raporte mbi ndryshimet e parametrave;
- Gjurmim të logimeve në sistem dhe në bazën e të dhënave (Log-et në DB).

Kjo strukturë siguron transparencë dhe auditim të çdo ndryshimi që kryhet në subject (njësi biznesi ose prone).

Menu “Import”

Mundëson shkëmbimin e të dhënave me sisteme të jashtme:

- **Import nga Bankat** – përditësim automatik i arkëtimeve ditore;
- **Import nga QKR** – integrim me të dhënat e bizneseve (në nivel serial nipti);
- **Raport i Mandateve të Konfirmuara** – verifikim i përputhshmërisë së pagesave.

Menu “Administrim” dhe “Backup”

Ky modul përdoret për administrimin e përdoruesve dhe sigurinë e sistemit:

- Krijimi dhe menaxhimi i përdoruesve, roleve dhe të drejtave;
- Rivendosja e fjalëkalimeve dhe menaxhimi i aksesit;
- Krijimi automatik i kopjeve rezervë (backup) dhe rikthimi i bazës së të dhënave.

Ky seksion garanton **siguri operative, rikuperim të shpejtë dhe gjurmueshmëri të plotë të aksesit në sistem.**

Sistemi përfshin mekanizma të integruar për:

- Validim automatik të të dhënave;
- Kontroll të aksesit sipas roleve dhe nivelit të autorizimit;
- Ruajtje të historikut të veprimeve për çdo përdorues.
- Dërgim i njoftimeve në E-Albania

Kjo ndërfaqe është ndërtuar me fokus në **efikasitet, siguri dhe transparencë**, duke i mundësuar DPTTV-së të operojë me standardet më të larta të administrimit fiskal.

4. INFRASTRUKTURA FIZIKE “HARDWARE”

Të dhënat për serverat jepen në tabelën më poshtë:

Nr.	Roli	Procesori (CPU)	Memorja (RAM)	Memorja (HDD)	Sistemi Operativ Instaluar	Marka	Modeli	Part Number	Pronësia	Vendndodhja
1.	SERV ER-254R4 5V	2 x Intel(R) Xeon(R) Silver 4210R @ 2.40GHz (8 cores)	128 GB	C: 2x 300 GB D: 1x 1.2TB	Windows Server 2019 st	Hp	ProLiant DL360 Gen10	735 151 - B2 1	DPTTV	DPTTV
2.	SERV ER-654FR 122	2 x Intel(R) Xeon(R) Silver 4210R @	128 GB	C: 1 x 240GB	Windows Server 2019 st	Hp	ProLiant DL360 Gen10	P23 578 -	DPTTV	DPTTV

		2.40GHz (8 cores)		D: 1x 1.2TB				B2 1		
3.	SERV ER-43JKF D	Intel® Xeon ® CPU E5-2620 v4 @2.10GHz	64 GB	C: 2x 300 GB D: 2x 1.2TB	Windows Server 2012 st	Lenovo	System x3650 M5	TC E1 26 Q-2.2 1	DPTTV	DPTT V

5. SPECIFIKIMET TEKNIKE TË SISTEMIT

5.1 Arkitektura e Sistemit

Sistemi Informatik i Taksave Vendore funksionon në një arkitekturë **klient-server**, ku aplikacioni i përdoruesit lidhet me bazën e të dhënave përmes një rrjeti të siguruar lokal (LAN) ose përmes VPN të dedikuar.

- **Aplikacioni Klient:** Zhvilluar në mjedisin **Unify SQLWindows 5.1**, me GUI desktop.
- **Serveri i Aplikacionit dhe Bazës së të Dhënave:** Oracle Database 11g R2, i instaluar në serverët qendrorë të DPTTV-së.
- **Sistemi Operativ i Serverit:** Microsoft Windows Server 2016 / 2019.
- **Komunikimi:** përmes protokollit TCP/IP në rrjet të mbyllur administrativ.
- **Siguria e të Dhënave:** përmes autentifikimit të përdoruesve, enkriptimit të komunikimeve dhe logimit të plotë të veprimeve.

5.2 Komponentët Kryesorë

1. **Moduli Klient-Server:** për përlllogaritjen, regjistrimin dhe raportimin e detyrimeve.
2. Moduli i Webservice-ve me AKSHI (shërbimet për biznesin qytetarë taksapagues dhe pagesat).
3. **Moduli i Njoftimeve në e-Albania:** për dërgimin e njoftimeve zyrtare tek subjektet.
4. **Moduli i Raportimit dhe Analizës:** për gjenerimin e raporteve statistikore dhe fiskale.
5. **Moduli i Backup dhe Rikuperimit:** për ruajtje automatike të bazës së të dhënave dhe rikthim në rast dështimi.

5.3 Platforma dhe Teknologjitë

Komponenti	Teknologjia / Platforma
Aplikacioni	Unify SQLWindows 5.1
RDBMS	Oracle 11g R2 Enterprise Edition
Webservice	SOAP / REST (HTTPS, TLS 1.3)
Server OS	Windows Server 2016 / 2019
Klient OS	Windows 10 / 11 Pro
Backup	Oracle RMAN + Kopje periodike fizike

Komponenti	Teknologjia / Platforma
Logim	Audit Log + Error Log i dedikuar
Integritet	AKSHI (API), Banka, e-Albania
Enkriptim	Certifikata dixhitale të lëshuara nga AKSHI

OE duhet të disponojë aplikacionet përkatëse, mjedisin/ ambientin e zhvillimit Unify SQLWindows 5.1 për zhvillimin e aplikacionit dhe/ ose çdo lloj tjetër aplikacioni, mjedisi/ ambienti të zhvillimit që të bëjë të mundur realizimin e objektit të prokurimit.

5.4 Kërkesat për Mirëmbajtje

- Monitorim periodik i performancës së serverit dhe bazës së të dhënave;
- Përditësime të aplikacionit sipas ndryshimeve ligjore (VKB / ligje tatimore);
- Kopje rezervë ditore dhe javore;
- Mbështetje teknike 24/7 për problemet kritike;
- Raportim periodik i incidenteve dhe përditësimeve.

5.5 SLA – Niveli i Shërbimit

Parametri	Kërkesa minimale
Disponueshmëria e sistemit	$\geq 99.5\%$ gjatë orarit zyrtar
Koha maksimale e reagimit për defekt kritik	≤ 2 orë
Koha e rikuperimit nga dështimi	≤ 6 orë
Raportim periodik i mirëmbajtjes	Çdo muaj

5.6 Siguria dhe Auditimi

- Autentifikim me përdorues dhe fjalëkalim unik të enkriptuar;
- Rivendosje e detyrueshme e fjalëkalimeve periodikisht;
- Auditim i plotë i logimeve të përdoruesve dhe aksesit në të dhëna;
- Ruajtje e logeve për çdo ndërhyrje (insert, update, delete) në detyrimet e subjekteve në lokacion të dytë fizik (off-site), minimalisht 12 muaj;
- Backup në lokacion të dytë fizik (off-site).

6. PËRGJIGJA DHE SHKALLËZIMI I SHËRBIMIT

Ky kapitull përcakton mekanizmat e reagimit dhe shkallëzimit që kontraktori duhet të zbatojë për zgjidhjen e çdo problemi teknik apo funksional që ndikon në funksionimin e sistemit të Taksave Vendore të Bashkisë Tiranë.

Objektivi kryesor është sigurimi i **reaksionit të shpejtë, ndjekjes efektive dhe zgjidhjes përfundimtare** të çdo incidenti, duke garantuar vazhdimësinë e shërbimeve.

6.1 Klasifikimi i Incidenteve

Incidentet klasifikohen sipas nivelit të ndikimit në funksionimin e sistemit dhe urgjencës së ndërhyrjes:

Niveli	Përshkrimi i incidentit	Shembuj
Kritik (Prioritet 1)	Ndërprerje totale e funksionimit të sistemit ose e moduleve kryesore; pamundësi për të hyrë në sistem; humbje ose korrupsion të dhënash.	Serveri i bazës së të dhënave jashtë funksioni; mosfunksionim i gjenerimit të detyrimeve.
I Lartë (Prioritet 2)	Funksionet kryesore janë të kufizuara, por sistemi operon pjesërisht.	Ndërprerje në komunikimin me bankat ose e-Albania.
Mesatar (Prioritet 3)	Problem që nuk ndikon në mënyrë kritike, por kërkon ndërhyrje për korrigjim.	Gabime në raportim, probleme vizuale ose parametrike.
I Ulët (Prioritet 4)	Çështje jo kritike, përmirësime të ndërfaqes ose optimizime të vogla.	Sugjerime për përmirësim të funksioneve.

6.2 Koha e Reagimit dhe e Zgjidhjes

Kontraktori duhet të respektojë kohët maksimale të reagimit dhe zgjidhjes për secilin nivel incidenti:

Niveli incidentit	Koha maksimale e reagimit	Koha maksimale e zgjidhjes
Kritik (P1)	≤ 1 orë nga raportimi	≤ 6 orë nga momenti i raportimit
I Lartë (P2)	≤ 2 orë	≤ 12 orë
Mesatar (P3)	≤ 4 orë	≤ 24 orë
I Ulët (P4)	≤ 8 orë	≤ 48 orë

Reagimi përfshin **kontaktin fillestar me institucionin, konfirmimin e marrjes së incidentit, dhe nisjen e analizës teknike.**

Në rastet kritike, ndërhyrja duhet të realizohet **në distancë (remote)** menjëherë, dhe **në terren (on-site)** nëse problemi nuk mund të zgjidhet përmes kanaleve elektronike.

6.3 Mekanizmi i Shkallëzimit

Në rastet kur një incident nuk mund të zgjidhet brenda afatit të përcaktuar, zbatohet procedura e shkallëzimit sipas niveleve të mëposhtme:

Niveli i Shkallëzimit	Përshkrimi / Përgjegjësia
Niveli 1 – Teknik	Trajtimi nga ekipi i parë i mirëmbajtjes (Helpdesk / Support).
Niveli 2 – Ekspertizë e specializuar	Përfshirja e zhvilluesve ose ekspertëve të bazës së të dhënave.
Niveli 3 – Shkallëzim Menaxherial	Njoftim dhe përfshirje e menaxherit të kontratës pranë Autoritetit Kontraktues.
Niveli 4 – Shkallëzim Jashtëm (kritik)	Njoftim i menjëhershëm i AKSHI-t dhe institucioneve përkatëse për incidente të sigurisë.

Shkallëzimi duhet të realizohet automatikisht në momentin që koha e zgjidhjes së një incidenti tejkalohet sipas nivelit të prioritetit.

6.4 Komunikimi dhe Raportimi i Incidenteve

Çdo incident duhet të regjistrohet në mënyrë të dokumentuar përmes:

- **Sistemit elektronik të raportimit (ticketing)** ose përmes email-it zyrtar të DPTTV-së;
- Për çdo rast, kontraktori duhet të dërgojë **raport të detajuar teknik** që përmban:
 - Datën dhe orën e raportimit;
 - Përshkrimin e problemit;
 - Shkakun teknik dhe hapat e ndjekur për zgjidhje;
 - Koha e ndërhyrjes dhe personat përgjegjës;
 - Masat parandaluese për të shmangur përsëritjen.

Raportet mujore duhet të përmbledhin:

- Numrin total të incidenteve sipas niveleve të prioritetit;
- Mesataren e kohës së reagimit dhe zgjidhjes;
- Përqindjen e incidenteve të mbyllura brenda afatit të SLA-së.

6.5 Mbështetja Teknike dhe Orari i Punës

- **Mbështetja on-line dhe telefonike:** 24 orë në ditë, 7 ditë në javë për rastet kritike;
- **Ndërhyrjet on-site:** gjatë orarit zyrtar 08:00–16:00, me mundësi zgjatjeje në rast emergjencash;
- **Mirëmbajtjet preventive:** planifikohet çdo 3 muaj me njoftim paraprak dhe miratim nga Autoriteti Kontraktues.

6.6 Gjurmueshmëria dhe Auditimi

Të gjitha incidentet, ndërhyrjet dhe raportet teknike duhet të jenë të **gjurmueshme dhe të verifikueshme** nga Autoriteti Kontraktues dhe audituesit e jashtëm. Kontraktori duhet të mbajë arkivë elektronike të plotë të logimeve të komunikimit dhe ndërhyrjeve teknike për periudhën e kontratës dhe minimum 12 muaj pas përfundimit të saj.

7. MIRËMBAJTJA, ZHVILLIMET DHE KONSULENCA TEKNIKE

7.1 Mirëmbajtja Operacionale

Kontraktori do të garantojë ofrimin e shërbimit të mirëmbajtjes për të gjithë komponentët e sistemit të Taksave Vendore, duke përfshirë:

- Serverët e aplikacionit dhe bazës së të dhënave Oracle 11g R2;
- Aplikacionet klient-server dhe webservice-t integruese;
- Procedurat e komunikimit me AKSHI-n (shërbimet për biznesin, qytetaret taksapagues dhe pagesat).

Mirëmbajtja do të përfshijë:

- **Monitorimin** ditor të performancës së sistemit dhe logeve;
- **Verifikimin e proceseve të backup-it** dhe rikthimin testues të të dhënave;
- **Azhornimet e sigurisë** për sistemin operativ, bazën e të dhënave dhe aplikacionin;
- **Rivendosjen e shërbimeve** në rast ndërprerjeje apo dështimi të pjesëmarrjes në rrjet;
- **Konsolidimin e indeksave dhe statistikave të Oracle-it** për optimizim të performancës.

Kontraktori është përgjegjës për garantimin e vazhdimësisë së punës dhe për përditësimin e dokumentacionit teknik pas çdo ndërhyrjeje të realizuar.

7.2 Mirëmbajtja Preventive

Përveç mirëmbajtjes reaktive, kontraktori do të kryejë edhe **mirëmbajtje preventive** periodike sipas axhendës së mëposhtme:

Frekuenca	Veprimet Kryesore
Ditore	Kontroll i logeve të aplikacionit dhe databazës; verifikim i proceseve të backup-it; testim i aksesit të përdoruesve.
Javore	Analizë e ngarkesës së sistemit dhe performancës së Oracle-it; pastrim i të dhënave të përkohshme; përditësim i parametrave të raportimit.
Mujore	Testim i rikthimit nga backup-et (restore); kontroll i kapaciteteve të storage; raportim i plotë i mirëmbajtjes mujore.
Tremujore	Auditim i logeve të përdoruesve, kontroll i versioneve të certifikatave dixhitale, analizë sigurie dhe rekomandime për optimizim.

Rezultatet e çdo mirëmbajtjeje preventive do të përfshihen në raportin mujor të performancës.

7.3 Zhvillimet dhe Përmirësimet e Sistemit

Gjatë periudhës së kontratës, kontraktori duhet të sigurojë:

- **Analizë të nevojave të reja ligjore ose fiskale** dhe përshtatje të sistemit sipas ndryshimeve të VKB-ve dhe ligjeve tatimore;
- **Përmirësim të moduleve ekzistuese** për rritjen e performancës, përdorshmërisë dhe sigurisë;
- **Shtim të raporteve analitike** sipas kërkesave të DPTTV-së;
- **Integrime/perditesime të shërbimeve në e-albania;**
- **Zhvillime/kerkesa nga AK për ndryshime në aplikacion.**
- **Zhvillimi i një ndërfaqeje që t'i mundësojë DKV-së aplikimin e faljes së gjobave dhe/ ose principalit, sipas fashave dhe kritereve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.**
- **Zhvillimi në sistem i funksionalitetit që, në rastet kur subjektit i rivlerësohen detyrimet, të gjenerohet automatikisht njoftimi për rivlerësim tatimor, në vend të njoftimit standard aktual të sistemit.**
- **Zhvillimi i një ndërfaqeje raportimi mbi njoftimet e dërguara në platformën e-Albania, sipas llojit të dokumentit, filtrave të statusit, përdoruesit, datës, vitit dhe kodit vendor.**

Çdo përmirësim ose zhvillim i ri duhet të shoqërohet me:

- dokumentacion teknik të detajuar,
- manual përdorimi,
- dhe testim verifikues nga komisioni i ndjekjes së kontratës.

7.4 Konsulenca Teknike

Operatori ekonomik duhet të ofrojë shërbime konsulence në aspektet e mëposhtme:

- **Analiza e performancës së sistemit dhe optimizimi i bazës së të dhënave;**
- **Këshillim për sigurinë kibernetike,** përfshirë auditimin e certifikatave, menaxhimin e fjalëkalimeve dhe aksesit;
- **Asistencë gjatë migrimeve teknologjike** ose integriteteve me sisteme të jashtme;
- **Trajnim për administratorët teknikë** mbi përdorimin e mjeteve të monitorimit, backup-it dhe logimit.

Konsulenca do të jetë e disponueshme me kërkesë të DPTTV-së dhe do të ofrohet me afat reagimi brenda 2 ditëve pune nga momenti i kërkesës zyrtare.

7.5 Raportimi i Mirëmbajtjes

Kontraktori duhet të përgatisë dhe dorëzojë:

- **Raport mujor** që përmbledh aktivitetet e mirëmbajtjes, testimet e backup-eve, përditësimet e sigurisë dhe performancën e sistemit;
- **Raport tremujor** për analizën e trendeve të performancës dhe rekomandimet për përmirësim;
- **Raport vjetor** për veprimtarinë e plotë të mirëmbajtjes, me analizë të SLA-së dhe propozime për zhvillime të ardhshme.

-
- **Raport** për incidentet dhe ndërhyrjet urgjente brenda ditës së ndodhur;

7.6 Afati i Zbatimit dhe Vazhdueshmëria e Shërbimit

Shërbimi i mirëmbajtjes do të ketë afat 12-mujor nga data e lidhjes së kontratës. Në përfundim të periudhës, kontrata mund të rinovohet në bazë të performancës dhe nevojave të institucionit.

Gjatë gjithë afatit, kontraktori duhet të garantojë **disponueshmëri 24/7 për rastet kritike** dhe reagim brenda afateve të përcaktuara në SLA.

Shtojca 7.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimet që kërkohen që kërkohen:

Afatet e ekzekutimit:

Nr.	Përshkrimi i shërbimit	Vendi i ekzekutimit	Afati
1	“Shërbim i Zhvillimit të Mirëmbajtjes së Programit të Taksave dhe Tarifave Vendore”.	DPTTV	12 (dymbëdhjetë) muaj

Shërbimi të ofrohet nga momenti i lidhjes së kontratës me afat 12 mujor.

Shtojca 8.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

TERMAT E REFERENCES

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve:

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve: Shërbim i Zhvillimit të Mirëmbajtjes së Programit të Taksave dhe Tarifave ” në cdo komponent të tij, me qëllim sigurimin e vazhdimësisë së punës me shërbimet e ofruara nga ky sistem.

Pavarësisht se kjo kontratë në thelb synon procesin e mirëmbajtjes së sistemeve të sipërpërmenduar, DPPTV- ja kërkon herë pas here të kryhen azhurnime, përmirësime apo modifikime të aplikimit apo infrastrukturës mbi të cilën ekzekutohet ky aplikim.

Detyrat:

Shpërndarja:

Vendi i kryerjes së shërbimeve: **Në zyrat e DPPTV-së.**

Shtojca 9.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi;
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas **Shtojcës 10**.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Referuar pikës 1 të shtojcës 8, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 10.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare një vlerë jo më të vogël se 40% të vlerës së fondit limit lëshuar nga autoriteti përkatës. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

2.2.2 Vetëdeklarim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2026, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas Ligjit Nr. 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar.

Kjo kerkese do te konsiderohet e permbushur gjate fazes se ofertimit me plotesimin e formularit te vetedeklarimit. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor do ti kërkojë ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve të deklaruar si më lart.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe/ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
ose
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të disponojë një punësim mesatar të paktën 7 (shtatë) punonjës të punësuar, të cilët të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për të paktën për muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave vërtetuar me:

- Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për të paktën muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.
- Listpagesat e punonjësve të konfirmuara nga autoritetet përkatëse sipas formatit që kerkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën për muajin e fundit të deklaruar, shoqëruar me formularët e deklarimit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.

(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotesimin e formularit te vetedeklarimit, këto dokumente do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).

2.3.3 Për të garantuar implementimin me sukses të kontratës, cilësinë e shërbimit të ofruar si dhe për të garantuar suportin përgjatë periudhës së parashikuar të mirëmbajtjes sipas dokumentit të termave të referencës, operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë staf të kualifikuar të diplomuar në një nga degët e Inxhinierisë Elektronike, Inxhinieri Informatike, Teknologji Informacioni, Informatikë, Informatikë Matematikë, Inxhinieri Matematike dhe

Informatike, Informatikë Ekonomike, Telekomunikacion, Inxhinieri Telekomunikacion, me kompetencat minimalisht si më poshtë:

- a) Të paktën 2 (dy) punonjës të certifikuar për administrimin e bazës së të dhënave ose ekuivalente.
- b) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për Testim Software ose ekuivalente.
- c) Të paktën 2 (dy) punonjës të certifikuar për zhvillim software ose ekuivalente.

Një punonjës mund të ketë 1 ose më shumë certifikime.

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- Diplomë përkatëse
- Certifikata/ Transkriptet përkatëse për specialistët e kërkuar;
- Deklarimin nga Operatori Ekonomik të personelit teknik/ profilin e punonjësve nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10, pjesa III, pika B;
- Kontratë punë.

Kjo kerkese do te konsiderohet e permbushur gjate fazes se ofertimit me plotesimin e formularit te vetedeklarimit. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor do ti kërkojë ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve të deklaruar si më lart.

